



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 12 Prot

Tiranë, më 18/02 2013

VENDIM Nr. 10 dt. 13.02.2013

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 13.02.2013, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

Lidhur me: Diskutim i kërkesave të qytetarëve

VENDOSI:

1. **Miratohet:** Projekt restaurimi, rikonstruksioni dhe përshtatje të objektit banesa e z. Veip Mustafaj sot në pronësi të z. Zoi Veip Klefti, znj. Dashuri Xhemil Klefti dhe znj. Gjyle Veip Mustafaj, K-007, Lagjia "Kala", Berat.
2. **Nuk Miratohet:** Restaurim dhe rivierësim i objektit "Ish Merkato Qendrore e qytetit të Beratit":
 - a. Të ripunohet fasada e objektit.
 - b. Të jepet një fotomontazh i zonës me objektet që ka përqark.
 - c. Të rivijë për miratim në KKR.
3. **Miratohet:** Projekt restaurimi dhe rikonstruksioni banesa e Z. Aleksandër Nako, lagja Mangalem, Berat.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ALDO BUMÇI

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE